

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE  
TETOR – DHJETOR 2022**

Nr. rendor	Data e Kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e Përgjigjes	Përgjigja	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	07.10.2022	<p>I nderuar Kryetar i Bashkisë, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), në zbatim të Urdhërit Nr. 318, datë 02.11.2020 “Për delegim kompetence”, është organi kompetent për nënshkrimin e licencave dhe certifikatave në transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus.</p> <p>Në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI), Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor ka implementuar Platformën elektronike e-Transport, një platformë e</p>	14.10.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj nr. 22673 Prot., Datë 03.10.2022 “Kërkesë për informacion në lidhje me terminalet e transportit ndërqytetës.”, protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me nr. 2948 Prot., datë 07.10.2022, si dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.224, datë 13.04.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transportit rrugor", Ju dërgojmë informacion se për linjat e rregullta të transportit ndërqytetës në Bashkinë Malësi e Madhe kemi një linjë Koplík-Shkodër e subjektit MALESIA TRAVEL shpk, sipas licencës nr.37 datë 03.06.2022 dhe me vlefshmëri deri në datë 02.06.2027.</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>dedikuar për transportin ndërqytetës të udhëtarëve me autobus.</p> <p>Në sistemin elektronik e-Transport përfshihen të gjithë aktorët e sektorit të transportit ndërqytetës, siç janë subjektet operuese, autoriteti kompetent i licencimit, agjencia e biletave, terminali për hipjen/zbritjen e udhëtarëve, të cilët ndërveprojnë me njëri - tjetrin në proceset e automatizuara të punës, me qëllim final përmirësimin e nivelit të shërbimit në këtë sektor.</p> <p>Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 224, datë 13.04.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 85, datë 8.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin, shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”, prerja e biletave në</p>				
--	--	--	--	--	--	--

		<p>transportin ndërqytetës do të kryhet nëpërmjet sistemit elektronik e- Transport, nga agjencitë e biletave, pajisjet e transaksionit elektronik të instaluar në mjetet e transportit rrugor ose kudo tjetër, online nëpërmjet aplikacioneve mobile dhe payment - gateway, zhvilluar nga AKSHI. Biletimi në transportin ndërqytetës nëpërmjet platformës e-Transport duhet të jetë gati brenda datës 1 Janar 2023. Për sistemin elektronik e-Transport është krijuar një faqe në internet ku do të publikohet informacioni për të gjithë sektorin e transportit ndërqytetës, duke përfshirë dhe Terminalet e Udhëtarëve, që në zbatim të Udhëzimit Nr. 446, datë 10.05.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra</p>			
--	--	---	--	--	--

	<p>e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”, pajisen me autorizim nga Kryetari i Bashkisë.</p> <p>Informacioni i publikuar në faqen në internet do të përdoret nga udhëtarët/turistët e huaj për adresën e saktë të nisjes dhe mbërritjes së mjeteve në transportin ndërqytetës si dhe prerjen e biletave të udhëtimit nëpërmjet sistemit elektronik e-Transport.</p> <p>Për sa më sipër, në respektim të afateve të vendosura nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 224, datë 13.04.2022, i përmendur më sipër, dhe në kuadër të popullimit me të dhëna të faqes në internet për sistemin elektronik e-Transport, kërkohet nga ana Juaj informacion në një kohë sa më shpejtë mbi vendnisjen/vendmbërritjen e</p>				
--	---	--	--	--	--

		miratuar nga ana Juaj për linjat e rregullta të transportit ndërqytetës				
2	07.10.2022	<p>Në mbështetje të ligjit Nr.20 datë 07.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësive në Republikën e Shqipërisë "neni 69, pika 9 , si dhe VKM nr. 1178/2020 botuar në fletoren zyrtare Nr.22 date 11.02.2021 "Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje ", si dhe në baze të ligjit 107/2014 " Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit " të ndryshuar kërkojme:</p> <p>► Informacion nga ana juaj nëse për: Objektin social-ekonomik 2 kat të vetedeklaruar me prot.3182, zk.3158, nr.pas. 881/2, fshati Reç, Bashkia Malesi e Madhe të vetedeklaruar nga subjekti M.S.H</p> <p>Nëse ka leje ndertimi apo është vendosur më parë prishja apo konfiskimi ose ka pasur dënime sipas nenit 46 të ligjit nr.</p>	12.10.2022	<p>Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 10380 Prot ,datë 05.10.2022 dhe protokolluar me tonën me Nr.2958 Prot, date 07.10.2022 në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi objektin në pronën e shtetasit M.S.H e ndodhur në Reç njs Adm Shkrel, Bashkia Malesi e Madhe:</p> <p>Ju informojme se në pronën e shtetasit M.S.H e ndodhur në Reç, njs Adm. Shkrel, Bashkia Malesi e Madhe nuk ka leje ndertimi si dhe nuk janë marrë masa as denime sipas Nenit 46 Te Ligjit Nr. 10279/2010 “Per kundërvajtjet administrative” nga ana e IVMT-së. Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka

		10279/2010 "Per kundërvajtjet administrative". Bashkëngjitur: Fragment harte i fotografimit ajror nga (ASIG) dhe planvendosje.				
3	07.10.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në R.Sh", neni 45, pika 3, kërkohet informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar; V.L	12.10.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.26010.Prot, datë 03.10.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.2960 Prot, datë 07.10.2022, ju informojmë se subjekti V.L person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXXXX me administrator znj. V.L rregjistruar me datë 09/09/2022 në QKR, me aktivitet në fushën Parukeri, me adresë Shkoder Koplik KOPLIK Rruga Koplik Qender, Ndertesa 30 Hyrja 1 4301, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !	Përfunduar	Nuk ka
4	21.10.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, "Për Regjistrimin e Biznesit", neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në R.Sh", neni 45, pika 3, kërkohet informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar;	27.10.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.27808.Prot, datë 17.10.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.3130 Prot, datë 21.10.2022, ju informojmë se subjekti F.G person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXXXX me administrator znj. F.G rregjistruar me datë 03/06/2021 në QKR, me aktivitet në fushën Bar-Restaurant, Bujtine, me adresë Shkoder Kelmend, Fshati Lepushe, Lagjia Mesi i Lepushes, Godine 1-kateshe, Zona	Përfunduar	Nuk ka

		F.G		Kadastrale 1721, Nr.pasurie 25/1, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !		
5	21.10.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar : C.Z	27.10.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.26802.Prot, datë 12.10.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.3132 Prot, datë 21.10.2022, ju informojmë se subjekti C.Z person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXXXX me administrator z. C.Z rregjistruar me datë 10/02/2003 në QKR, me aktivitet në fushën Tregtim te artikujve te ndryshem, me adresë Shkoder Koplík, Lagjja Llazan, Rruga Shkoder-Koplík, godine 1-kateshe, zona kadastrale 2220, nr.pasurie 9/44, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj !	Përfunduar	Nuk ka
6.	24.10.2022	Gjatë shqyrtimit administrativ të praktikës së vetëdeklaruar nga z.Gj.P.K me nr. 381 prot, datë 13.11.2006, përgodinë social-ekonomike 1 (një) kat, nga verifikimi PPV Malesi e Madhe në faqen zyrtare te	27.10.2022	Në përgjigje të kërkeses suaj me nr. 11116 Prot, datë 19.10.2022 dhe protokolluar me tonën me Nr.3138 Prot, datë 24.10.2022 në lidhje me kërkesën tuaj për informacion mbi objektin social ekonomik I (një) kat në pronen e shtetasit Gj.P.K e ndodhur në Koplík, Rruga	Përfunduar	Nuk ka

		<p>AKPT-së konstatohet që ka një rrjet rrugor të propozuar. Ndodhur në këto kushte në mbështetje të ligjit Nr.20 datë 07.05.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" pika 18 ; si dhe VKM nr. Nr.1040, datë 25.11.2020 PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË ZBATIMIT TË KRITEREVE TË LEGALIZIMIT DHE MIRATIMIT E MODELIT TË AKTIT TË LEGALIZIMIT, PËR NDËRTIMET PA LEJE, pika 15, kërkojmë informacion nëse ka projekt konkret të miratuar të infrastrukturës rrugore . Duke ju falenderuar për bashkëpunimin !</p>		<p>Komuna Namur, Bashkia Malësi e Madhe:          Ju informojme se në objektin social ekonomik I(një) kat në pronen e shtetasit Gj.P.K nuk ka projekt konkret të miratur të infrastrukturës rrugore bazuar në PPV të bashkisë Malesi e Madhe në faqen zyrtare të AKPT          Ju faleminderit për bashkëpunimin!</p>		
7	07.11.2022	<p>Të nderuar,          Në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësisë të Prefektit (Ligji Nr. 107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut\ neni 3 dhe 8), mbështetur në Ligjin 93/2015, datë 27.07.2015 "Për turizmin",</p>	16.11.2022	<p>Ne përgjigje të shkresës suaj Nr. 60\40 Prot. e datës 02.11.2022, po ju dërgojmë informacione të detajuara sa i përket pikave të mëposhtme.          1.Investimet e kryera për zhvillimit e turizmit (me fondet publike)          Sistemim asfaltim rruga Linaj: Vlera X lekë</p>	Përfunduar	Nuk ka

	<p>neni 20, Urdhrin e Prefektit Nr. 40, datë 10.04.2019 “Për krijimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit”, kërkojmë informacion të hollësishëm mbi punën e bërë dhe problemet e konstatuara nga institucioni/njësia juaj e vetëqeverisjes vendore, lidhur me zbatimin e planit të masave (miratuar nga ana juaj) dhe planit të veprimit në nivel qarku në menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2022 (duke e krahasuar edhe me sezonin e viteve të kaluara 2021 e 2019), me të dhëna për:</p> <p>Investimet e kryera për zhvillimin e turizmit (me fondet publike e të biznesit)</p> <p>Menaxhimi i mbetjeve</p> <p>-Numri i Kontratave, të nënshkruara, me subjektet private, për përdorimin e hapësirave publike, për ushtrim veprimtarie të stacionit të plazhit</p> <p>Zbatimi i kushteve dhe standardeve, në përputhje me kriteret e përcaktuara në</p>		<p>Sistemim asfaltim rruga e liqenit ne Culaj: Vlera X lekë</p> <p>Përmirsim i aksesit dhe vizibilitetit të ujvarave në fshatin Vermosh dhe Lepushe: Vlera X lekë</p> <p>2.Nr. i pushuesve sipas zonave:</p> <p>a.Koplik: 0</p> <p>b.Qender: 0</p> <p>c.Kastrat 57</p> <p>d.Gruemire: 0</p> <p>e.Kelmend: 1565</p> <p>f.Shkrel: 1285</p> <p>g.Total: 2908</p> <p>3.Nr. i pushuesve ne Bujtina</p> <p>a.1325 pushues</p> <p>4.Nr. i subjekteve private qe ushtrojnë aktivitet ne sektorin e turizmit (Bujtina, kafe, restorante)</p> <p>a. Struktura akomoduese Total: 23</p> <p>-Bujtina: 11</p> <p>-Bar-Kafe + Restorante: 132</p> <p>-Guida Turistike: 2</p> <p>5.Nr. i të punësuarve në veprimtarinë turistike</p> <p>Nuk disponojmë informacion (informacioni mund te merret te Dr. Rajonale e Tatimeve ose zyra e punës)</p> <p>6.Të ardhurat nga veprimtaria turistike</p> <p>Te ardhurat Janar- Tetor 2022 nga taksa e Fjetjes në hotel: X Lekë</p>		
--	--	--	--	--	--

	<p>Rregulloren “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (miratuar me VKM Nr. 171, datë 27.03.2019, i ndryshuar), në ushtrimin e veprimtarisë së stacioneve të plazhit (nga subjektet private, të cilat përdorin, sipas kontratës, hapësirat publike për veprimtarinë e stacionit të plazhit; si dhe nga bashkia për stacionet e plazhit publik).</p> <p>Monitorimi i zbatimit të kushteve dhe standardeve.</p> <p>-Garantimi i rendit dhe sigurisë tek pushuesit</p> <p>Menaxhimi i zhurmave</p> <p>-Numri i aktiviteteve kulturore dhe të traditës të zhvilluara gjatë sezonit (në total, dhe sipas zonave turistike e Njësive Administrative)</p> <p>-Numrin e pushuesve/turistëve (në total dhe sipas zonave e pikave turistike)</p> <p>-Numri i vizitorëve/turistëve në muzetë e qytetit dhe kalanë “Rozafa”</p> <p>-Numrin e pushuesve të akomoduar në strukturat</p>		<p>7.Numri i aktiviteteve kulturore dhe të traditës të zhvilluara gjatë sezonit.</p> <p>Logu i Bjeshkëve, Lëpushe, Njësia administrative Kelmend</p> <p>Festa e Tamares. Tamare, Njësia administrative Kelmend</p> <p>Takimi i Lahutarëve, Koplík,Njesia administrative Qendër</p> <p>Dita e Turizmit Malor, Razem, Njësia administrative Shkrel</p> <p>8.Problemet e konstatuara</p> <p>Mosmbajtja e regjistrit turistëve</p> <p>Mosdhënia e informacionit për numrin e vizitorëve në kohë reale nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e turizmit</p> <p>Ushtrimi i aktivitetit bujtinë në objektet e banimit, kjo bën të vështirë identifikimin e këtyre subjekteve.</p>		
--	--	--	---	--	--

		<p>akomoduese-Bujtinë, Fjetinë (Hostel), Motel, Hotel, Resort (në total dhe sipas zonave e pikave turistike)</p> <p>-Numri i subjekteve private, të cilat ushtrojnë aktivitet në sektorin e turizmit (Struktura akomoduese, stacione plazhi, Bar-Kafe, Restorante, shërbime shëndetësore, operator turistik, etj.)</p> <p>-Numri i të punësuarve në sektorin e turizmit (numri i kontribuesve në total dhe sipas zonave- e pikave turistike)</p> <p>Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria turistike</p> <p>-Numri i kontrolleve, inspektimeve dhe monitorimeve të kryera (në total dhe sipas zonave e pikave turistike);</p> <p>Gjetjet e rezultuara, masat dhe rekomandimet e dhëna</p> <p>Funksionimi dhe përmirësimi i shërbimit të kujdesit shëndetësor, të MZSh, të furnizimit me energji elektrike e ujë të pijshëm.</p> <p>Probleme të hasura, të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin</p>			
--	--	---	--	--	--

		e objektivave dhe pritshmërive në zhvillimin e turizmit.				
8	08.11.2022	Bazuar në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007, “Për Regjistrimin e Biznesit”, neni 49, çregjistrimi vullnetar si dhe në ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në R.Sh”, neni 45, pika 3, kërkojmë informacion në lidhje me detyrimet tatimore për subjektin e poshtëshënuar; H.U	09.11.2022	Në përgjigje të shkresës suaj Nr.29672.Prot; datë 01.11.2022 "Kërkim informacioni", protokolluar nga Bashkia Malësi e Madhe me Nr.3309 Prot, datë 08.11.2022, ju informojmë se subjekti H.U person fizik me numër Nipti: XXXXXXXXXXXX me administrator z. H.U rregjistruar me datë 08/04/2016 në QKR, me aktivitet në fushën Bar kafe, me adresë Shkoder Shkrel BOGE Rruga Nacionale Koplík-Dedaj, godine 1-kateshe, nr 134, zona kadastrale 1234, nuk ka detyrime fiskale vendore ndaj Bashkisë Malësi e Madhe. Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!	Përfunduar	Nuk ka
9	11.11.2022	Për nevoja hetimore në lidhje me veprën penale “Kultivim i bimëve narkotike“ parashikuar nga neni “284“ i Kodit	14.11.2022	Në vijim të shkresës tuaj me nr prot 1810 me date 11.11.2022 protokolluar me tonen me nr prot. 3367 dt. 11.11.2022 ku ju kërkoni informacion për nevoja	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Penal,kërkojmë nga ju informacionin e mëposhtëm: Vendi që i korospondon koordinata gjeografike e mëposhtme: N 42° 20' 45" E 19°32'4"</p> <p>1)Është pronë private apo shtetërore? 2)Nëse është pronë private, kujt i përket? 3)Nëse është pronë shtetërore a është dhënë me qera të tretëve, nëse po, kujt?</p> <p>Për arsye hetimore kërkohet informacionin e mësipërm sa më shpejt të jetë e mundur. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>		<p>hetimore në lidhje me veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike" "parashikuar nga neni "284" i Kodit Penal me koordinata gjeografike : N 42° 20'45"E 19° 32'4"</p> <p>Ju sqarojmë se Bashkia Malësi e Madhe nuk posedon informacione për statuset juridike për pronat pasi është ASHK kompetente sipas ligjit 11/2018" Për kadastrën"</p> <p>Sipas VKM Nr. 433, datë 8.6.2016, i ndryshuar, janë miratuar listat e inventareve për transferimin e pyjeve dhe kullotave publike në pronësi të Bashkive, procedurë e cila nuk është përfunduar akoma dhe vazhdon të jetë në shqyrtim. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!</p>		
10	11.11.2022	<p>Për nevoja hetimore në lidhje me veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike" parashikuar nga neni "284" i Kodit Penal,kërkojmë nga ju informacionin e mëposhtëm: Vendet që i korospondojnë koordinatat gjeografike të mëposhtme: 1.N 42° 10'59.9" E 19°34'58.3" 2.N 42° 11'08.7" E 19° 34'58.1"</p>	14.12.2022	<p>Në vijim të shkresës tuaj me nr prot 1809 me date 11.11.2022 protokolluar me tonen me nr prot. 3368 dt. 11.11.2022 ku ju kërkoni informacion për nevoja hetimore në lidhje me veprën penale "Kultivimi i bimëve narkotike" "parashikuar nga neni "284" i Kodit Penal me koordinata gjeografike : N 42° 10' 59.9" E 19° 34'58.3" N 42° 11' 08.7" E 19° 34'58.1"</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>1)Janë pronë private apo shtetërore?</p> <p>2)Nëse janë private, kujt i përkasin?</p> <p>3)Nëse janë pronë shtetërore a janë dhënë me qera të tretëve, nëse po, kujt?</p> <p>Për arsye hetimore kërkojmë informacionin e mësipërm sa më shpejt të jetë e mundur. Duke ju falenderuar per bashkëpunimin.</p>		<p>Ju sqarojmë se Bashkia Malësi e Madhe nuk posedon informacione për statuse juridike për pronat pasi është ASHK kopetente sipas ligjit I 1/2018“ Për kadastrën“ Sipas VKM Nr. 433, datë 8.6.2016, i ndryshuar, janë miratuar listat e inventareve për transferimin e pyjeve dhe kullotave publike në pronësi të Bashkive, procedurë e cila nuk është përfunduar akoma dhe vazhdon të jetë në shqyrtim.</p>		
11	17.11.2022	<p>Për nevoja hetimi të procedimit penal Nr.1347 i vitit 2022, kërkojmë nga anaj Juaj informacion nëse përgjatë muajit dhjetor të vitit 2021, është konstatuar ndonjë rast i prerjeve apo dëmtimeve të paligjshme të pyjeve, në zonën e Razmës, territor i Bashkisë Malësi e Madhe. Nëse po, të na vihet në dispozicion një kopje e njehsuar me origjinalin, e procesverbalit të konstatimit të kundravajtjes.</p>	12.12.2022	<p>Për sa kërkonti në shkresën tuaj Nr 9817 Prot. Datë 15.11.2022 e administruar nga ana jonë me shkresën Nr.3436 Prot. date 17.11.2022 ju informojme si më poshtë : Gjate muajit dhjetor 2021 nga ana e Inspektoreve te pyjeve nuk eshte konstatuar ndonje rast i prerjeve te pyjeve ne zonen e Razmes dhe nuk kemi procesverbal te konstatimit te kundervajtjes qe te jete mbajtur per prerje te pyjeve ne ate zone. Faleminderit per mirëkuptimin!</p>	Përfunduar	Nuk ka

		<p>Për shkak të afateve të punës sonë, lutemi që përgjigjen të na e dërgoni sa më shpejt të jetë e mundur.</p> <p>Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!</p>				
--	--	--	--	--	--	--